



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagradi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ETEAM" Sh.P.K. të datës 23.12.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i mbeturinave" me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ETEAM" Sh.P.K. të datës 23.12.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i mbeturinave" me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.
- DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korrigjin e Gabimeve në Njofimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korrigjin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- NJOFTOHET** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "ETEAM" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 23.12.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i mbeturinave" me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistonë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqë 1 nga 4

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**P.1.** - "Tek kapaciteti teknik dhe profesional autoriteti kontraktues ka përcaktuar kërkesën si në vijim "Kërkesa nr.2 Duhet të dorëzohet licenca për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leja mijedisore për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leje mijedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga Komuna e Prishtinës). ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Licenca për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leja mijedisore për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leje mijedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga Komuna e Prishtinës)." Kërkesa e lartcekur është kërkësë diskriminuese për OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht favorizuese për OE të caktuar, përfaktin se kjo kerkese e perzgjedhjes nuk eshte dashur te vendost tek kapaciteti teknik dhe profesional sepse ju mundeson OE te cilet nuk jane profesional dhe nuk jane te licencuar te jene LIDER dhe te shperblehen me kontrate, pasi qe kjo keres duhet te vendost tek kriteret e perzgjedhjes - Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale qe do te thote se vetem OE te cilet jane te licencuar mund te tenderojn dhe te shperblehjen me kontrate sepse netyra e prokurimit eshte e tille qe vetem OE te cilet posedojn kete licenen mund te tenderojn ne kete AP dhe jo tu mundesohet OE te cilet fare skan te bejne me netren e ketij aktiviteti te prokurimit te ju mundesohet te tenderojn permis konsosrcumeve te ndryshme, andaj kerkojm qe kjo keres te vendost tek pershtatshmira professional die ne asnjë menyre tek kapaciteti teknikdhe professional – lusim AK te analizoj dhe te shqytroj dhe te permiresoj DT dhe NJ dhe te vendos aty ku e obligon nen 69 dhe 70 i LPP-se".

- Pretendimi është i bazuar dhe AK do të korrigoj DT duke zhvendosur kërkesën për licensim nga kërkesat teknike te pjesa e kërkesave të përshtatshmërisë.

**P.2.** - "2. Tek kapaciteti teknik dhe profesional autoriteti kontraktues ka përcaktuar kërkesën si në vijim "Kërkesa nr. 3. Menaxher i projektit inxhinier i mijedisit (bachelor). ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "3. CV-a, diploma, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Kërkesa e lartcekur është kërkësë diskriminuese për OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit eshte diskriminues dhe shume e paqrite dhe me shume kuptimesi pasi qe nuk kuptohet e pranohet INXHINER apo Bachelor, prandaj AK te hartoj kritere te perzgjedhjes ashtu sic obligon nenini 69 i LPP-se dhe nen 17 dhe 25 i Rreg. Nr. 002/2024 – versioni i konsoliduar per PP".

- Kërkesa nuk është e paqartë pasi që specifikohet konkretisht se kërkohet inxhinier i mijedisit me nivel të shkollimit bachelor. Pretendimi është i pabazuar.

**P.3.** - "Tek kapaciteti teknik dhe profesional autoriteti kontraktues ka përcaktuar kërkesën si në vijim "Kërkesa nr.4 LLTOT 1, 2 dhe 3 -të gjithë kamionët e mbeturinave të jenë të pajisur me një sistem të avancuar identifikimi (idenSystem) të integruar në pjesën e pasme të kamionit. Ky sistem duhet të bëjë leximin e qipave RFID të cilët janë të vendosur në kontejnerët e mbeturinave. I gjithë ky sistem duhet të jetë i lidhur me internet në mënyrë që të dhënat e zbrazjeve të përcillen në kohë reale në Softwarin C-Trace të cilin e posedon Komuna e Prishtinës, ose ndonjë software të ngjashëm që e kryen funksionin e njëjt. ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: Një deklaratë të nënshkruar nga OE me dëshmi që i posedon paisjet e kërkura ose në rast se OE-ja nuk posedon paisjet mbi pronësinë atëherë OE-ja duhet te ofroj marrëveshjen përmarrjen me qira të paisjeve. Gjithashtu OE është i obliguar që paisjet ti ketë në vendpunishtë të vet, brenda në Kosovë, ku

Faqe 2 nga 4

---

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)

*Autoriteti Kontraktues, komisioni i vlerësimit e bënë verifikimin e pajisjeve të prezantuara në listën e pajisjeve. OE 72 orë më herët njoftohet zyrtarisht lidhur me vizitën në teren nga ana e komisionit”.*

- Kërkesa në fjalë ndërlidhet me kapacitetin teknik të pajisjes. Prandaj pretendimi është i pabazuar. Për operatorët që kanë paqartësi, ekziston mundësia që të kërkohen svarime shtesë te AK sipas LPP në fuqi dhe brenda afatit të përcaktuar.

**P.4.** – “*vlefshmeria e tenderit per vlera te medha shtet makizmum 90 dite ndersa sigurimi i tenderit kerkohet vetem 30 dit eme teper se sa vlefshmeria e tenderit, andaj keto kërkesa paraqesin barr per OE kur dihet se vlera e ketyre sigurimeve eshte shume e larte prandaj keto kërkesa janë shpenzim i panevoshem per OE dhe na habit fakti se pse AK i shkele keto dy nenen te rregullores pa asnjë arsyje dhe asnjë fakte perveq se e favoizojn kompanit e sigurimit qe te perfitojne sa me shume nga OE qe tendrojn ne tenderet qeveritar, due gene nje barre krejt e pa nevoshem dhe e pa arsyshtme”.*

- Përmes nenit 30.2 të RRPP përcaktohet se “Kërkesa për periudhë të validitetit të tenderit do të jetë: a. Në minimum 90 ditë për kontrata me vlerë të madhe”. Pra për tender me vlerë të madhe maksimumi i validitetit nuk është 90 ditë por minimumi është 90 ditë. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

**P.5.-** “*Pajisjet e mëposhtme të specifikuara në aneksin 7 janë të panevojshme – kundërthënëse në vet-vete, te pa qarta , jo te kuptueshme dhe jo proporcional me natyrën për këtë aktivitet të prokurimit”.*

- Llojet dhe sasitë e pajisjeve të kërkua janë në përputhje me qëllimin dhe natyrën e aktivitetit të prokurimit. Si tilla janë të domosdoshme për realizimin me sukses të aktivitetit të prokurimit. Megjithatë AK do të korrigoj vetëm renditjen e pajisjeve në kuptim të ndarjes së tyre sipas peshës.

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit**, fillimi sh duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në rastin konkret njësia kërkuese ka korrigjuar specifikat teknike dhe specifikat teknike të azhurnuara do të publikohen nga sektori i prokurimit përmes formularit për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

---

#### Faqe 3 nga 4

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vodosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënët më sipër është vodosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 27.12.2023

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 4 nga 4

---

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000  
Tel.: 038-200-40-111  
Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)